



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PROJEKTEVE, POLITIKAVE, STRATEGJIVE NË FUSHËN E DREJTËSISË DHE E INTEGRIMIT EVROPIAN

# Newsletter

PRILL 2023

## EVENTE PUBLIKE

### Procesi i integritit: Hartimi i Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës

Në vijim të procesit të negociatave, në pritje të screening report, Ministria e Drejtësisë në zbatim të Metodologjisë së Rishikuar të Zgjerimit të Bashkimit Evropian ka iniciuar takimet konsultuese me institucionet kontribuese për kapitullin 23 me qëllim hartimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës.

Gjatë muajit prill janë mbajtur 15 takime koordinuese me më shumë se 55 institucione kontribuese për kapitullin 23 me fokus çështjet si gjyqësori, antikorrupsioni, të drejtat e njeriut.



### Mbahet Konferenca Kombëtare për Shoqërinë Civile

Drejtorja e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, në datën 24 Prill 2023, mori pjesë në Takimin Kombëtar të Shoqërisë Civile, takim i cili synon identifikimin e prioriteteve tematike për secilën fushë veprimi të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile (KKSHC) si dhe artikullimin e pritshmërive mbi rolin e KKSHC-së për vitin 2023 me fokus të shtuar, rolin dhe kontributin e shoqërisë civile në procesin e negociatave dhe më gjerë.

[Për më shumë.](#)

## NDËRGJEGJËSIMI

### Leksion i hapur me studentët e Universitetit “Aleksandër Xhuvani” mbi negociatat dhe anëtarësimin në BE

Në vijim të aktiviteteve informuese kushtuar procesit të negociatave dhe integritit, Drejtoria e Integritit dhe Negociatave pranë Ministrisë së Drejtësisë së bashku me Universitetin “Aleksandër Xhuvani” kanë organizuar më datë 5 prill një leksion të hapur, me temë “Negociatat e anëtarësimin të Shqipërisë në BE – Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”.

Leksioni i hapur u mbajt nga Zëvendësministrja e Drejtësisë, njëkohësisht dhe negociatore për Kapitullin 23 dhe Kriterin Politik, znj. Adea Pirdeni, e cila paraqiti një ekspozë të rrugëtimit të Shqipërisë drejt integritit në Bashkimin Evropian si dhe prezantoi hapat konkretë të procesit të negociatave.

[Për më shumë.](#)





## Diskutim i draft raportit të monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025

Drejtorja e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, në vijim të konsolidimit të Raportit të Monitorimit për vitin 2022 të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025, organizoi në datën 13 Prill 2023, takimim e Grupeve Tematike me qëllim njohjen me draftin e parë të raportit. Tryeza e rrumbullakët synoi gjithashtu, përcaktimin e rregullave për mbledhjet e ardhshme.

## Takim me temë sundimi i ligjit në Ballkanin Perëndimor

Më datë 11 dhe 12 prill, përfaqësues të Drejtorisë së Negociatave dhe Integritimit të Ministrisë së Drejtësisë morën pjesë në takimim rajonal me temë “Lëre ligjin të sundojë Rajonin” i cili u zhvillua në Beograd, Serbi. Në këtë takim morën pjesë gjithashtu përfaqësues nga Maqedonia e Veriut dhe Serbia, ndër to edhe Ministria përgjegjëse për çështjet e integritimit evropian të Serbisë, përfaqësues nga administra shtetërore, organizata të ndryshme, akademikë dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Takimet kishin si qëllim shkëmbimin e eksperiencave midis vendeve që po punojnë për të njëjtin qëllim që lidhet me integritimin në familjen evropiane.



## Parlamenti Evropian miraton liberalizimin e vizave për Kosovën

Më 18 prill Parlamenti Evropian miratoi liberalizimin e vizave për Kosovën duke u mundësuar qytetarëve të Kosovës udhëtimin drejt shteteve anëtare të BE-së pa viza për një qëndrim 90 ditë në harkun e 180 ditëve. Kësisoj i gjithë Ballkani Perëndimor ka një rregjim të ngjashëm vizash si ai në hapërisën Schengen.

[Për më shumë.](#)